



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.02, datë 09.11.2022

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
“RESTAURIMI DHE RIKUALIFIKIMI URBAN I ZONËS PERSPEKTIVE TID TË
GJENDUR NË PARKUN ARKEOLOGJIK TË DURRËSIT”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues Bashkisë Durrës, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID të gjendur në parkun arkeologjik të Durrësit”, me subjekt zhvillues Bashkinë Durrës.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.7, datë 24.11.2021 “Rikualifikim urban i Parkut Arkeologjik të Durrësit – Faza 1”, Bashkia Durrës, me zhvillues Ministrinë e Kulturës, shfuqizohet.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I KULTURËS

ELVA MARGARITI



SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ABELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 21 / 12 /2023